



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 350 Prot.

Tiranë, më datë 29.04.2022

VENDIM
Nr. 115, datë 29.04.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 29.04.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e Vlerësimit të Potencialit Arkeologjik i realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama, në kuadër të projektit “Rindërtim (për shkak të demtimeve nga tërmeti i datës 26.11.2019) në objektin ekzistues 1 kat me çati”, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “B” të qytetit të Durrësit, me aplikues Z. Endi Rexha dhe zhvillues Znj. Manuela Selishta, Shtyrë Vendimmarrja me Vendim KKTKM nr. 29, datë 02.02.2022;
 2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Rindërtim (për shkak të demtimeve nga tërmeti i datës 26.11.2019) në objektin ekzistues 1 kat me çati”, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “B” të qytetit të Durrësit si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

